



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 365, Datë 13.07.2023

PËR

RICAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT Z. {...}, NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “ë” dhe nenin 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 45, pika 4, shkronja “a” dhe pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës dhe nevojave të Gjykatës Administrative të Apelit, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 18.07.2026.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 18.07.2023.
3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR